



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:180131

Datë: 14.03.2025

Numri i dokumentit: 06990905

P.nr. 896/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË P-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësor, Driton Haliti, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurit, Sami Zeka, për shkak të veprës penale, “Ndërtim pa leje”, nga neni 359 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në P-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1478/2023, të dt. 20.10.2023, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar, të dt.06.03.2025, në prezencë të Prokurorës së Shtetit, Nora Tigani, të pandehurit Sami Zeka, dhe mbrojtësit të tij av. Blerim Ademaj, sipas autorizimit, në të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.14.03.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

SAMI ZEKA, i biri i R. dhe nënës H., e gjinisë Sh., i lindur me dt. në P, me vendbanim në P, rr. “ K. e B.”, ka të kryer shkollën e mesme, me lnj.nr....., me profesion-t., i martuar, baba fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Prej datës së pavërtetuar, në vazhdimësi deri me datë rreth orës 11:00 në Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna në fshatin Sh. të R. i pandehuri kryen punë ndërtimore pa leje paraprake të Drejtorisë së Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor të Komunës së Ps, në atë mënyrë që gjatë kontrollës së terrenit nga policia në kuadër të planit operativ së bashku me Rojën e natyrës së Parkut Kombëtar është vërejtur se i pandehuri kishte ndërtuar një deban (stan), bazamenti i stanit me material betoni zhavorr, edhe pse i vetëdijshëm se ndërtimi po kryhej në pronën publike me destinim të veçantë dhe pa leje valide nga organet kompetente.

-për çka ka kryer veprën penale “Ndërtimi pa leje” nga neni 359 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7, 38, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, dhe nenit 359 par. 4 e lidhur me par. 2 të KPRK-së, dhe nenit 364 të KPP-së të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën e verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk do të kryej veprën tjetër penale.

I pandehuri obligohet në paguarjen e shpenzimeve të paushallit gjyqësor në shumë prej 30 € (tridhjetë euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 20 € (njëzetë euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I Pandehuri -URDHËROHET – të bëjë rrënimin e ndërtimit pa leje, të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, dhe atë brenda afatit kohor prej 60 (gjashtëdhjetë) ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa shpenzimet me rastin e rrënit bartën nga i pandehuri.

Pala e dëmtuar, Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtarë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në P-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.1478/2023, të dt. 20.10.2023, kundër të pandehurit Sami Zeka, për shkak të veprës penale “Ndërtim pa leje” nga neni 359 par. 3 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPP-së me dt. 06.03.2025, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në prezencë të prokurorës së shtetit, Nora Tigani, të pandehurit Sami Zeka, dhe mbrojtësit të tij, av. Blerim Ademaj.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par. 1, të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta, dhe për avokat mbrojtës ka angazhuar av. Blerim Ademaj sipas autorizimit.

Pas leximit të aktakuzës, nga Prokurorja e Shtetit, Gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësi të pandehurit që të deklarohet për

pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimi të fajësisë.

I pandehuri ka deklaruar se e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndihet i penduar, dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i njëjti është bërë në mënyrë të vullnetare dhe konform dispozitave ligjore, qëndron në tërësi pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik të veprës penale, i ka propozuar gjykatës që me rastin e caktimit të dënimit pranimi i fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese, gjykata të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit.

Mbrojtësi i të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me atë si mbrojtës, i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese, me rastin e marrjes se vendimit mbi dënim.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 241 dhe 242 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: Raporti i oficerit K. Z. #. i dt. 07.06.2023, raporti informues i hetuesit S. A. #... i dt. 08.06.2023, deklarata e dëshmitarit A. Ç. i dt. 07.06.2023, deklarata e të pandehurit Sami Zeka i dt. 04.07.2023, Procesverbal mbi kontrollin e kryer i dt. 10.07.2023, Fotoalbumi i vendit të ngjarjes, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 242 par 6 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit Sami Zeka, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, Ndërtim pa leje nga neni 359 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri ishte i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori, pranimin e fajësisë, shprehjen e pendimit për veprën e kryer, ndërsa rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të

pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nënpar 2.6 të KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar për paushallin gjyqësor në shumën prej 30 (tridhjetë) euro, duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë , si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform dispozitës së nenit 359 par. 5 të KPRK-së, Gjykata te pandehurin e urdhëroi të rrënojë objektin e ndërtuar pa leje, ku shpenzimet e rrënimit do të barten nga i pandehuri.

Konform nenit 462 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, pala e dëmtuar DAPK-P, është udhëzuar në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË P-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.896/23 dt.14.03.2025

Praktikanti gjyqësor
Driton Haliti

GJYQTARI
Shaqë Curri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.